





JAVA NDËRGJEGJËSUESE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË KRIMIT

 BERAT

Në kuadër të Javës Ndërgjegjësuere për Mbrojtjen e Viktimave të krimit, Ministria e Drejtësisë, përfaqësuar nga Zëvendës Ministri i Drejtësisë z. Klajd Karameta dhe znj. Elona Hoxha, Drejtoreshë e Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, në bashkëpunim me znj. Patricia Pogace, Drejtoreshë pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas zhvilluan një takim ndërgjegjësues pranë Bashkisë Berat, ku u pritën nga Nënkrjetarja e Bashkisë znj. Etleva Dhima.



 BERAT

Në kuadër të Javës Ndërgjegjësuese për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit, Zëvendës Ministri i Drejtësisë, z. Klajd Karameta, dhe znj. Elona Hoxha, Drejtoreshë e Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, në bashkëpunim me znj. Patricia Pogace, Drejtoreshë pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, realizuan një takim informues në Shkollën e Mesme Profesionale "Stiliano Bandilli" në Berat.



Në kuadër të Javës Ndërgjegjësuese për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit, Ministria e Drejtësisë, përfaqësuar nga Zëvendës Ministri i Drejtësisë z. Klajd Karameta dhe znj. Elona Hoxha, Drejtoreshë e Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, në bashkëpunim me znj. Klejda Poci përfaqësuese nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, zhvilluan një takim informues pranë Bashkisë Korçë, ku u pritën nga Zv. Kryetarja e Bashkisë znj. Benila Themeli.

 KORÇË

Zëvendës Ministri i Drejtësisë, zoti Klajd Karameta, znj. Elona Hoxha, Drejtoreshë e Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, së bashku me znj. Klejda Poci, Drejtoreshë pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas zhvilluan një leksion të hapur me studentë nga Universiteti "Fan Noli", Korçë.



 KORÇË



VIZITË E AMBASADORES SË AUSTRISË, DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS DHE PËRFAQËSUESVE TË UNDP NË QSHNJP ELBASAN

UNDP Albania, Ambasadorja e Austrisë, Monika Zach, Kreu i zyrës Rajonale të Agjencisë Austriake për zhvillim, David Munckenhuber dhe Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, Ergys Qirici, patën një takim me kryetarin e Gjykatës së Elbasanit dhe vizituan QSHNJP Elbasan.



INTERVISTË E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS, ZOTIT ERGYS QIRICI, PËR TELEVISIONIN MCN

Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, zoti Ergys Qirici, u intervistua nga Televizioni MCN. Në këtë intervistë, zoti Qirici u fokusua te shumëfishimi i përfituesve të Ndihmës Juridike Falas.



INTERVISTË E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS, Z. ERGYS QIRICI, PËR RADIO TELEVISIONIN SHQIPTAR

Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, zoti Ergys Qirici, u intervistua nga Radio Televizioni Shqiptar, ku paraqiti objektivat e Ndihmës Juridike Falas për vitin 2025.



HEDHJA E SHORTIT PËR ÇAKTIMIN E AVOKATËVE QË DO TË OFROJNË SHËRBIME TË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Në përputhje me udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë, Nr.17, datë 05.08.2020 "Për caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të Ndihmës Juridike Dytësore në proceset civile dhe administrative" u hodh shorti dhe u përgatit lista me avokatët e përzgjedhur për të ofruar shërbimin e Ndihmës Juridike Falas.



MBËSHTETJA E AKSESIT TË QYTETARËVE NË DREJTËSI NËPËRMJET NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, zoti Ergys Qirici, ishte i ftuar në një takim të organizuar në kuadër të projektit "Mbështetja e aksesit të qytetarëve në drejtësi nëpërmjet ndihmës juridike falas në Shqipëri".

FUQIZIMI I NDIHMËS JURIDIKE FALAS NË SHQIPËRI

Në kuadër të Projektit EFLAS u zhvillua mbledhja e Komitetit Drejtues, në ambientet e UNDP Albania, ku ishte i pranishëm edhe zoti Ergys Qirici, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

TRAJNIM PËR OSHC E LICENSUARA QË OFROJNË NDIHMË JURIDIKE FALAS

Drejtoresha e Drejtorisë së Zbatimit dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore, znj. Patricia Pogace, ishte e ftuar në trajnimin me temë: "Mbrojtja e të drejtave të konsumatorit dhe siguria ushqimore". Trajnimi u organizua nga ACC, ANTTARC dhe Bashkimi Europian. Një nga sesionet e takimit i dedikohet OSHC të licensuara që ofrojnë Ndhmë Juridike Falas.



JAVA NDËRGJEGJËSUESE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË KRIMIT

Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me QSHNJP Tiranë vendosën standën informuese pranë Ministrisë së Drejtësisë në kuadër të Javës Ndërgjegjësuere mbi Viktimat e Krimit 15- 22 Shkurt 2025.

QSHNJP Tiranë në datë 14.02.2025 realizoi një aktivitet indërgjegjësues në kuadër të Javës për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit pranë Shoqatës ARSIS.

QSHNJP Tiranë në datën 21.02.2025 realizoi një takim pranë Qendrës Kombëtare Tranzitore të Emergjencave me fokus informimin mbi Ndhmën Juridike Falas në kuadër të Javës për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit.

QSHNJP Tiranë në datën 18.02.2025 në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Qendrës për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ishte e ftuar në një takim informues pranë Gjimnazit "Sami Frashëri".

QSHNJP Tiranë ishte e ftuar në një takim nga Organizata "Të Ndryshëm të barabartë" në kuadër të Javës Ndërgjegjësuere mbi Viktimat e Krimit.

QSHNJP Dibër zhvilloi në datën 17.02.2025 zhvilloi një takim informues në Shkollën e Mesme "Sehit Najdeni" ku informoi nxënësit dhe mësuesit mbi përfitimin e Ndhmës Juridike Falas nga viktimat e krimit.

QSHNJP Dibër realizoi një aktivitet informues në kuadër të Javës për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit në Shkollën e Mesme, Maqellarë.

QSHNJP Pogradec në datën 20.02.2025 realizoi aktivitetin ndërgjegjësues në Shkollën 9 vjeçare "Shefki Muçllari", Vërdovë. Aktiviteti kishte në fokus informimin mbi ligjin nr.111/2017 "Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti".

QSHNJP Pogradec në datën 20.02.2025 ishte e ftuar në takimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, Bashkia Pogradec. Në këtë takim u fol mbi sigurinë, punën, bashkëpunimin dhe kontributin që jep çdo institucion.

QSHNJP Pogradec në kuadër të Javës Ndërgjegjësuere mbi Viktimat e Krimit, realizoi në datën 25.02.2025 në Shkollën 9 vjeçare, Rëmenj, një aktivitet informues mbi Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore.

QSHNJP Pukë në datën 25.02.2025 u ftua në një takim informues me temë “Mbrojtja e fëmijëve” nga Shoqata “Agro - Puka” dhe Shoqata “Dorcas”.



QSHNJP Fier në datën 17.02.2025 mori pjesë në tryezën teknike të organizuar nga Qendra “Platforma Kombëtare për Gratë” ku u diskutua Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024 - 2030.

QSHNJP Fier në datën 20.02.2025 zhvilloi një takim me pjesëtarë të kategorisë viktimat të krimit, ku synonte informimin mbi Ndhimën Juridike Falas dhe ligjin nr.111/2017 “Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti” .

QSHNJP Korçë në datën 20.02.2025 realizoi një aktivitet informues mbi viktimat e krimit me nxënës dhe mësues të Shkollës “Stavri Themeli”.



QSHNJP Shkodër në datën 19.02.2025 ishte e ftuar në një takim informues mbi viktimat e krimit pranë Shkollës “Jordan Misja”, Shkodër.

QSHNJP Shkodër në datën 20.02.2025, në kuadër të Javës Ndërgjegjësuere për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit, mori pjesë në një takim ndërgjegjësues të organizuar nga Komuniteti “Papa Xhovani XIX” ku u diskutua ligji nr.111/2017 “Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti”.

QSHNJP Elbasan në datën 21.02.2025 realizoi aktivitetin ndërgjegjësues në kuadër të Javës Ndërgjegjësuere për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit një takim pranë Shoqatës ACIPSN.

QSHNJP Elbasan në datën 21.02.2025 zhvilloi një takim pranë Fasonarisë “Eria Textiles”, Elbasan, mbi informimin për viktimat e krimit dhe Ndhimën Juridike Falas.



QSHNJP Lushnje, zhvilloi në datën 20.02.2025 një takim ndërgjegjësues me gra dhe vajza të kategorisë së veçantë viktimat të krimit. Aktiviteti synonte informimin e tyre mbi Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti.

QSHNJP Tropojë në datën 21.02.2025 organizoi një aktivitet informues me nxënës të Shkollës së Mesme “Asim Vokshi”, Tropojë, ku u diskutua mbi viktimat e krimit si subjekt përfitues i ligjit nr.111/2017 “Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti”.



QSHNJP Gjirokastër dhe QSHNJP Përmet kanë realizuar në datën 19.02.2025 një aktivitet në bashkëpunim me Qendrën e Dhunës në Familje në kuadër të Javës Ndërgjegjësuere mbi Mbrojtjen e Viktimave të Krimit. Në aktivitet u bë prezantimi i ligjit nr.111/2017 “Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti”.

QSHNJP Gjirokastër dhe QSHNJP Përmet kanë zhvilluar në datën 21.02.2025 një aktivitet informues mbi Javën Ndërgjegjësuere për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit, me përfitues të Ndhimës Juridike Falas nga kategoritë e veçanta, pranë ambienteve të QSHNJP Gjirokastër.



QSHNJP Lezhë në datën 18.02.2025 organizoi në bashkëpunim me Organizatën “Të Ndryshëm, të barabartë” një Open Day me synim informimin e qytetarëve mbi Ndhimën Juridike Falas.

QSHNJP Lezhë zhvilloi në datën 21.02.2025 një aktivitet Street Law ku informoi qytetarët e Lezhës mbi Ndhimën Juridike Falas, në kuadër të Javës Ndërgjegjësuere për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit.



QSHNJP Vlorë organizoi në datën 14.02.2025 një tryezë diskutimi në kuadër të Javës Ndërgjegjësuere për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit në ambientet e Qendrës “Aulona”, Vlorë.

QSHNJP Vlorë zhvilloi në datën 18.02.2025 një takim me avokatet e Ndhimës Juridike Dytësore të Qendrës “Vatra”, ku u diskutua ndihma për viktimat e krimit.

QSHNJP Vlorë ishte pjesë e takimit të hapur ndër institucional që zhvilloi Bashkia Vlorë, më datë 20.02.2025. Në takim u bisedua mbi kontributin që çdo institucion mund të japë për mbrojtjen dhe trajtimin e denjë të viktimave të krimit.





QSHNJP Durrës organizoi në 24.02.2025 një aktivitet Street Law në Kuadër të Javës Ndërgjegjësuese për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit.

QSHNJP Durrës në datën 27.02.2025 zhvilloi një aktivitet informues mbi Ndhimën Juridike Falas në kuadër të Javës Ndërgjegjësuese për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit

QSHNJP Kurbin në datën 24.02.2025 ishte ftuar në një takim, në kuadër të Javës së Ndërgjegjësimit mbi Mbrojtjen e Viktimave të Krimit, nga përfaqësues të Shërbimit Social, Bashkia Kurbin. Gjatë takimit u vu theksi te pozicioni i viktimave të krimit brenda sistemit të drejtësisë.



QSHNJP Pukë në datën 26.02.2025 organizoi një takim ndërinstitucional me synim informimin mbi Qendrën e Shërbimeve të Ndhimës Juridike Parësore Pukë.

QSHNJP Fier në datën 20.02.2025 organizoi një takim informues pranë Njesisë Administrative Cakran në kuadër të promovimit të Ndhimës Ligjore Falas si dhe informimit mbi kategoritë që e përfitojnë atë.

QSHNJP Korçë në datën 18.02.2025 realizoi një takim informues mbi ligjin nr.111/2017 "Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti", pranë Spitalit Rajonal Korçë, në kuadër të Ditës Botërore të Kancerit.



QSHNJP Korçë në datën 18.02.2025 realizoi një intervistë me fokus Ndhimën Juridike Falas dhe shërbimet e ofruara nga QSHNJP Korçë për vitin 2024, për televizionin lokal RTSH Korça.

QSHNJP Korçë në datën 20.02.2025 mori pjesë në takimin e organizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të 15 vjetorit të ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Bashkinë Maliq dhe Bashkinë Pustec.



QSHNJP Elbasan, në datën 21.02.2025 zhvilloi një takim pranë "Shoqatës së Jetimëve" në Elbasan me pjesëmarrjen e kategorive të ndryshme përfituese të ligjit nr.111/2017 "Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti". Aktiviteti u krye në kuadër të Ditës Botërore të Kancerit.

QSHNJP Lushnjë, ishte e ftuar në datën 12.02.2025 në një aktivitet të organizuar nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, Bashkia Lushnje. Takimi synonte informimin e të miturve për përfitimin e Ndhimës Juridike Falas si kategori e veçantë dhe ligjin nr.111/2017 "Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti".

QSHNJP Gjirokastrë në datën 25.02.2025 ishte e ftuar në seminarin me temë: "Mekanizmi i referimit të çështjeve në Ndërmjetësim".



QSHNJP Gjirokastrë në datën 25.02.2025 ishte e ftuar në një tryezë të rrumbullakët të organizuar në kuadër të javës kundër diskriminimit.

QSHNJP Gjirokastrë në datën 26.02.2025 u intervistua nga media lokale RTSH Gjirokastrë mbi shërbimin e Ndhimës Ligjore Falas.

QSHNJP Vlorë në datën 27.02.2025 ishte e ftuar nga Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit, në një Open Day, për pritjen e ankesave të qytetarëve.

QSHNJP Përmet në datën 24.02.2025 mori pjesë në leksionin e hapur të zhvilluar pranë gjimnazit "Sami Frashëri", Përmet, në kuadër të Javës Kundër Diskriminimit.

QSHNJP Tiranë në datat 26,27 dhe 28 Shkurt ishte e ftuar në trajnimin me temë: "Mbrojtja e të drejtave të konsumatorit dhe siguria ushqimore". Një nga sesionet e trajnimit lidhej me OSHC e licensuara që ofrojnë Ndhimë Juridike Parësore.

QSHNJP Lezhë në datën 28.02.2025 ka zhvilluar një aktivitet Street Law me fokus informimin e qytetarëve mbi ligjin nr.111/2017 "Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti" në kuadër të Ditës Botërore të Kancerit.

